

## **VËNDIM NR. 6**

### **I ASAMBLESE SE PERGJITHSHME TE ANETAREVE TE SHOQATES “CHAMBRE DE COMMERCE ET INDUSTRIE FRANCE – ALBANIE”**

- Sot, me datën 29.04.2021, në orën 15 :00, online, u mbledh Asambleja e Pergjithshme e shoqates « Chambre de Commerce et Industrie France-Albanie », **me rend dite:**
1. Regjistrimi: Identifikimi nga notarija - Disa informacione teknike- Blerina Kazhani
  2. Fjala e Kryetarit
  3. SHS Ambasadorja e Francës në Shqipëri, Zj. Elisabeth Barsacq
  4. Vendim për të shtyrë mandatin e anëtarëve të KD në fuqi për një periudhë prej 12 muajsh
  5. Bilanci i aktiviteteve 2020 e strategjia e CCI për vitin 2021-2022
  6. Raporti moral dhe financiar 2020
  7. Prezantimi I kandidatëve
  8. Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit Administrues 2021-2023 (*votim i fshehtë online*)
  9. Pyetje të ndryshme
- ▶ Asambleja i organizoi punimet e saj nën drejtimin e Kryetarit të Shoqates Z. Julien Roche, sekretare e Asamblese Zj. Blerina Kazhani, Drejtore Ekzekutive e kesaj shoqate si dhe në praninë e Noteres së dhomes së noterise Tirane Zj. Lorena Shkjezi Karafili.
  - ▶ Në Asamble moren pjesë 38 anetare, kater nga te cilet u larguan gjate votimit te Organeve te Keshillit Drejtues te Shoqates dhe nuk moren pjesë në miratimin e ndryshimeve statutore.
  - ▶ Në drejtimin e kryetarit të kesaj mbledhje u bë pershendetja e pjesmarresve dhe prezantimi i rendit të dites.
  - ▶ Kryetari i jep fjalën SHE Ambasadores së Francës, Zj. Elisabeth Barsacq si Presidente Nderi e Dhomës
  - ▶ Me pas u vijua me një raportim të veprimtarive të shoqates nga ana e Drejtores ekzekutive të saj Zj. Blerina Kazhani.
  - ▶ Pergjegjesi i Thesarit Z. Teit Gjini, njohu pjesëmarrësit e Asamblese me Raportin vjetor Financiar të vitit 2020.
  - ▶ Pas këtyre prezantimeve, takimi u pasua nga pika vijuese: Vendimi për zgjatjen me dymbëdhjetë muaj të mandatit të anëtarëve të Keshillit Drejtues aktual

***Asamblejai miratoi me shumicë absolute prej 34 votash vendimin për zgjatjen e mandatit të dymbëdhjetë muajve të anëtarëve të Keshillit Drejtues në detyrë***

- ▶ Kryetari propozon të modifikojë **NENET 15, 16, 18 e 19** te statutit si me poshte:
- ▶ Neni 15: *Menaxhimi i veprimtarive të CCIFA i është besuar Këshillit të Administrimit, pa shpërblim, i cili përbëhet nga anëtarë të zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme, jo më pak se 7, por jo më shumë se 9.*
- ▶ Neni 16. *Kandidatët për postin e 1 (një) - Presidenti, 3 (tre) - Zevendës Presidentëve, 5 (katër) - Administratorëve, një nga të cilët Administrator & Përgjegjës i Financës, i propozohen për votë Asamblesë së Përgjithshme.*
- ▶ Neni 18: *Në rast vakance për arsye të dorëheqjes, vdekjes ose shkaqe të tjera, Këshilli i Administrimit duhet të shtojë përkohësisht një administrator të ri sipas listës së zgjedhjeve të mëparshme për të arritur numrin minimal prej 7 anëtarësh deri në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme.*
- ▶ Neni 19. *Për çdo dy vite financiare, Asambleja e Përgjithshme zgjedh (me votim të fshehtë): Një president, tre Zëvendës Presidentë dhe pesë Anetare të Këshillit Drejtues, nga të cilët një Anetar Këshilli është edhe & Përgjegjës i Financës...*

**Asambleja Votoi me 38 vota pro, 0 abstenim dhe 0 vota kunder ndryshimin e neneve 15, 16, 18, et 19, si me sipër**

- ▶ Me pas u vijua me **prezantimin e Kandidateve** për Anetare të Organeve të Këshillit Drejtues në radhë si me poshte :
  1. Julien Roche
  2. Diana Ylli
  3. Zgjim Mita
  4. Patrick Paskal
  5. Jean Alain Jouan (mungon, përfaqësohet nga Zj. Blerina Kazhani)
  6. Odhise Zoto
  7. Eni Kalo
  8. Gjergji Themeli
  9. Florian Hasko
- ▶ Ne perfundim të prezantimit të tyre, sipas shpjegimeve të Noteres Lorena Shkjezi Karafili dhe një kontrolli të fundit të kryer prej saj, për pjesëmarrjen në votim dhe vlefshmerinë e votes, u vijua me votimin për anetaret e organeve drejtuese.

**Ne perfundim të votimit, Noterja Lorena Shkjezi Karafili e ndihmuar nga tekniku Ervin Kurti dhe drejtori ekzekutiv i CCIFA, numroi votat dhe në fund të numerimit rezultoi :**

- ▶ Pjesëmarrja në votim 34 anetare.
- ▶ Flete votimi të vlefshme 34.
- ▶ Flete votimi të pavlefshme 0.

#### **❑ LISTA E TË ZGJERDHURVE**

**Kryetar : Julien Roche 33 vota**

Pergjegjes i Thesarit	Diana Ylli	34 vota
Zv. Kryetare	Zgjim Mita	28 vota
	Patrick Paskal	25 vota
	Jean Alain Jouan	26 vota
Anetare te Keshilli Drejtues	Odhise Zoto	25 vota
	Eni Kalo	29 vota
	Gjergji Thelemi	23 vota
	Florian Hasko	28 vota

Në fund të votimit, Noteri, i ndihmuar nga tekniku dhe drejtori ekzekutiv i CCIFA, numëroi votat dhe deklaroi rezultatet

**□ SI PERFUNDIM, ASAMBLEJA E PERGJITHSHME VENDOSI**

**1. Miratimin e te gjitha pikave te rendit te dites si edhe propozimin per ndryshime ne statutin e shoqates « Chambre de Commerce et Industrie France-Albanie » te neneve 15, 16 e 19**

**2. Asambleja zgjodhi organet e saj Drejtuese si me poshte :**

Kryetar:	Julien Roche
Pergjegjes i Thesarit:	Diana Ylli
Zv. Kryetare:	Zgjim Mita Patrick Paskal Jean Alain Jouan
Anetare te Keshilli Drejtues:	Odhise Zoto Eni Kalo Gjergji Thelemi Florian Hasko

**3. Autorizimin e Z. Julien Roche dhe Zj. Blerina Kazhani, per te ndjekur proceduren per regjistrimin e ketij Vendimi Asambleje me gjithe ndryshimet perkatese qe ai sjell ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Tirane, si dhe depozitimin prane kesaj Gjykate te Statutit te Shoqates me ndryshimet perkatese.**

Mbajtur ne Tirane, me 29.04.2021

Kryetari i Asamblese se Pergjithshme  
Julien Roche

Sekretar i Asamblese se Pergjithshme  
Blerina Kazhani

\*\*\*\*\*